



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 317/1 Prot.

Tiranë, më 21 / 02 / 2020

V E N D I M

Nr. 21, Datë 21 / 02 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 12, datë 12.02.2020, të P.S kundër Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, në datë 27.12.2019 ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të konkuruar për pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë e Shërbimit Ligjor të rishpallur në datë 06.12.2019 nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA). Ankuesi pretendon se i plotëson të gjitha kushtet e posaçme që kërkoheshin në procedurën e rekrutimit, pasi ka përfunduar studimet universitare për drejtësi në vitin 2002, në sistemin 4-vjeçar, pranë Universitetit të Tiranës, me mesataren 8.4 dhe ka eksperiencë pune më shumë se 15 vjet në administratën publike. Ankuesi informon se, KPA, në datë 17.01.2020, nëpërmjet postës elektronike (e-mail), e ka njoftuar se: *“Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit, Komiteti Ad Hoc ka vendosur skualifikimin tuaj për shkak se, në procedurën e mëparshme, të zhvilluar më datë*

¹ Referuar e-mail-it datë 17.02.2020, P.S deklaron se i përket kategorisë së atyre aplikantëve konkret apo potencial, që kanë eksperiencë pune në administratën publike, më shumë se 7 vjet dhe që skualifikohen pa arsye nga konkurimi.

18.01.2019 të Komitetit Ad Hoc jeni vlerësuar si kandidaturë me eksperiencë të papërshtatshme”. Ankuesi deklaroi se përpara aplikimit të mësipërm, ka aplikuar dhe dy herë të tjera pranë KPA-së për pozicionin “Këshilltar Ligjor”. Aplikimi i parë është bërë në vitin 2017, për të cilin në datë 28.12.2017 është njoftuar se KPA-ja kishte zgjedhur të emërojë në pozicionin e këshilltarëve ligjorë disa kandidatë, ndërmjet të cilëve ai nuk ishte i përzgjedhur. Aplikimin e dytë ankuesi e ka bërë në vitin 2019, për të cilin në datë 21.01.2019 është njoftuar nga KPA-ja se Komiteti Ad Hoc ka vendosur skualifikimin e tij për shkak të eksperiencës së papërshtatshme.

Subjekti ankues informon se, në kërkesat e posaçme për pozicionin e “Këshilltarit Ligjor” përcaktohet se, kandidati duhet të ketë përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet, ndërkohë që ankuesi ka 15 vjet eksperiencë pune në administratën publike, pra nga ana e KPA-së ka pasur një trajtim të padrejtë në vlerësimin e eksperiencës së punës.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përsëritjen e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes nga ana e KPA-së.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 13.02.2020, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime, lidhur me shkakun e pretenduar (përkatësia në një grup të veçantë) dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me kandidatët e tjerë për shkakun e pretenduar.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me e-mail-in datë 17.02.2020 ka informuar Komisionerin si më poshtë: “Në thelb të ankimit të tij qëndron pretendimi për diskriminim në lidhje me përkatësinë e tij në kategorinë e atyre aplikantëve konkret ose potencial, që kanë eksperiencë pune në administratën publike më shumë se 7 vjet dhe që skualifikohen pa arsye nga konkurimi, si dhe ankimi i tij mbështetet vetëm në krahasimin me parashikimet ligjore, pasi nuk ka informacion për kandidatët e tjerë”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga ankuesi pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi, përkatësia në një grup të veçantë. Ankuesi pretendon se, grupi i veçantë përbëhet nga ata aplikantë konkret apo potencial, që kanë eksperiencë pune në administratën publike më shumë se 7 vite dhe që skualifikohen pa arsye nga konkurimi. Në këtë kontekst, ankuesi e lidh dhe justifikon shkakun e diskriminimit të pretenduar, me aplikantët që plotësojnë kriterin e eksperiencës në punë por që skualifikohen pa arsye.

Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se nuk e gjen të bazuar në ligj si një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi të gjithë kandidatët që kanë aplikuar, si të kualifikuar dhe të skualifikuar, janë të detyruar, nga kriteret e publikuara, të kenë eksperiencë pune më shumë se 7 vite në administratën publike dhe kjo karakteristikë nuk e bën ankuesin që ti përkasë një grupi të veçantë.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të Ligjit 10221/2010, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvete është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, ankuesi nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat e tij personale apo të një grupi të veçantë.

Komisioneri vlerëson se, shtetasi P.S mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të padrejta të Komitetit Ad Hoc, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe

për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit P.S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA